



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 788 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 01 . 07 .2010

Lënda: Dërgohet raporti statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Qershor 2010

Drejtuar: **Z. BUJAR NISHANI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po Ju paraqesim raportin statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Qershor 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konceptoi: Saimir Shyti
Datë 01.07.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T
PËR MUAJIN QERSHOR 2010

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Qershor 2010.

I. Statistika

Për periudhën 01-30 Qershor 2010, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 30 Qershor 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën 01.06.2009 - 30.06.2010, është 1733 të dënuar.

Nga 01.06.2009 deri më datë 30.06.2010, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **56** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **1677 të dënuar.**

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyrjen në komunitet nga Shërbimi i Provës **787** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **297** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **299** të dënuar me dënime alternative.
 - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **294** të dënuar me dënime alternative.
- 2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.**

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **1677** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **56**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **79** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **42** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **43** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **49** të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, shtesa për muajin Qershor 2010 (nga 01.06.2010 - 30.06.2010), prej **181** të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën **01.06.2009 - 30.06.2010**, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- **1363** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë", shifër

kjo e barabartë me **78.65 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- **27** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me **1.56 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **152** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", shifër kjo e barabartë me **8.77 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- **191** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "Lirim me kusht", shifër kjo e barabartë me **11.02 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysmëliria".

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në **Tabelën 2**.

Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 - 30.06.2010.

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	1363	78.65%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	27	1.56%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	191	11.02%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	152	8.77%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0%
TOTALI		1733	100%

Për periudhën 01.06.2009 - 30.06.2010 numri i të dënuarve me "punë në interes publik" është **152**, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 46 të dënuar, Shërbimi i Proves ka nën mbikëqyrje 106 të dënuar.

4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për muajin Qershor 2010:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykata 61 raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë 26 raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur 181 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 34 urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.

Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën **01.06.2009 - 30.06.2010** jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata **833** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë **231** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **1733** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **244** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për **56** të dënuar.

II. Bashkëpunimi me OJF-të dhe pushtetin vendor.

Në zbatim të memorandumeve të bashkëpunimit që Shërbimi i Provës ka nënshkruar me OJF-të e specializuara që ofrojnë shërbime të ndryshme, të

nevojshme për realizimin e programit të riintegrit të të dënuarve në periudhë prove, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

1. Kështu me Fondacionin "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve", janë zhvilluar 4 takime me të dënuarit e mitur dhe familjarët e tyre, si dhe me të dënuar të moshave të reja deri 21 vjeç, lidhur me prezantimin e shërbimeve të specializuara që ofron ky fondacion në fushën e ndërmjetësimit, për këta të dënuar dhe viktimave të tyre. Këto takime u organizuan në qytetet Shkodër, Tiranë, Durrës dhe Fier, me të dënuar që mbkëqyren nga Zyrrat Vendore respektive. Nga drejtuesi i këtij fondacioni, z. Rasim Gjoka, u bë prezantimi i projektit për ndërmjetësimin për të dënuarit e mitur dhe të rinjtë me moshë deri 21 vjeç, si dhe u mbajtën diskutime nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe nga zyrtarë të tjerë nga Shërbimi i Provës lidhur me çështje të informimit në lidhje me Shërbimin e Provës dhe aplikimin e drejtësisë restauruese për të dënuarit gjatë kohës së provës. U vu re një interesimin nga të dënuarit dhe familjarët e tyre në lidhje me këto çështje. Këto takime patën vlerë edhe për një prezantim të specialistëve të zyrave vendore të Shërbimit të Provës me ndërmjetësit e licencuar që punojnë pranë këtij fondacioni për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të rasteve që mund të hasen në të ardhmen në lidhje me ndërmjetësimin të dënuar-viktimë.

2. Gjithashtu në datën 16 Qershor 2010, u zhvillua një aktivitet me shoqatën "Aksion Plus", që ofron shërbime në fushën e riintegrit të personave të dënuar, përdorues të drogave dhe substancave narkotike dhe psikotropike, në Tiranë me studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, për dënimet alternative dhe zbatimin e tyre në Shqipëri. U vu re iteresimi i studentëve në lidhje me dënimet alternative dhe rolin që ka Shërbimi i Provës për zbatimin e tyre si dhe asisitimn e tij për riintegritin e të dënuarëve në shoqëri.

3. Në datën 29 Qershor 2010, nën mbështetjen e Prezencës së OSBE-së, në Shqipëri, u zhvillua një seminar trajnues me temë "Alternativat e dënimit me burgim dhe mundësitë e bashkëpunimit me pushtetin vendor." Ky seminar me pjesëmarrjen e punonjësve social të pushtetit vendor nga 20 bashki dhe komuna të vendit, me të cilët Shërbimi i Provës ka lidhur memorandume bashkëpunimi, u zhvillua në ambjentet e Prezencës së OSBE-së, në Tiranë. Vlen të përmendet faki që tashmë lektorët trajnues në

këtë seminar ishin të gjithë punonjës nga Shërbimi i Provës. Kështu temat që u trajtuan, u mbajtën nga Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, z. Saimir Shyti, zj. Esmeralda Velaj, si dhe nga Drejtori i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë z. Abdyl Spahiu. Në fund për pjesmarrësit u shpërndanë çertifikata të nënshkruara nga përfaqësuesi i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Keshilltari i Lartë Ligjor, z. Mathias Zander dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Ndërkohë që vazhdon puna dhe korespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunat e tjera.

III.-Problematika e punës.

1.- Problem i Hapjes se Zyrave Vendore te reja.

Problemi kryesor vazhdon të mbetet hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje të paktën në rrethet gjyqësore Lezhë, Korçë, Elbasan, Gjirokastër me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji. Nga ana jonë ju është dërguar shkresë për gjetjen e ambjenteve për ushtrimin e detyrave funksionale për zyrat që presim të hapen, tiullarëve të pushtetit vendor në këto qarqe, por deri tani përgjigjet kanë qenë negative.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikqyrje nga institucioni ynë **1677** të dënuar, ose mesatarisht **56 të dënuar për çdo specialist**, numër i cili vazhdon të rritet, dhe që është më i lartë se standartet e vendeve europiane, ku numri mesatar i të dënuarve për specialist është rreth 35 persona, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe **35 raporte vlerësimi për specialist**, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive.

Gjithashtu, vihet re së fundmi edhe rritja e numrit të kërkesave për raporte vlerësimi nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore gjë që e bën të papërbalueshme ngarkesën e punës.

Pra, për sa më sipër, në këto kushte emergjente në të cilat ndodhemi, e ripërsërisim kërkesën tonë, për hapjen e Zyrave të reja Vendore, për të zbatuar me korrektësi detyrat që na ngarkon ligji.

2. Problem i shtimit të organikës.

Me shkresën tonë nr. 493 prot., datë 03.12.2009, Ju kemi parashtruar dhe problemin e shtimit të organikës së Shërbimit të Provës, kerkesë e cila është shumë e nevojshme për t'u realizuar për shkaqet e përmendura në atë shkresë.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

